

## **NJOFTIM MBI LISTËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË EGZEKUTIVE**

- **1 ( një) “Specialist”, në Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integritit**

### **Kategoria e pagës III-b.**

Njësia Përgjegjëse, pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 25 të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të pikës 9, të Kreut VII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në përfundim të verifikimit paraparak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, ju njoftojmë se për pozicionin e shpallur, deri në datën 19.09.2022, nuk është paraqitur asnjë kandidaturë/nuk ka kandidatë të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit.

Për këtë arsye kalohet në procedurën e pranimit në kategorinë egzekutive

**Vëmendje!! Duke filluar nga data 28.09.2022-03.10.2022, do të njoftohen nëpërmjet faqes së KDIMDP-së, të gjithë kandidatët që kanë aplikuar (deri në datë 26.09.2022), për procedurën e pranimit në kategorinë egzekutive, mbi listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret për të vazhduar fazën e dytë të vlerësimit, datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurrimi.**

**Njësia Përgjegjëse**